



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 39

Tiranë – E martë, 15 mars 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 176, datë 9.3.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar 2847
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 9.3.2016	Për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2016..... 2847
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 9.3.2016	Për miratimin e marrëveshjes shumëpalëshe, të Autoritetit Kompetent, për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare..... 2847
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 9.3.2016	Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Biznesit..... 2858
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 9.3.2016	Për përcaktimin e sasisë minimale të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit 2016 në sektorin e transportit..... 2863
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 182, datë 9.3.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”..... 2864
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 183, datë 9.3.2016	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “PARTIZANI” sh.a., si qiramarrës, për pasurinë “Ambiente të pronës nr. 4, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 4030, rruga “Myslym Keta”, Tiranë”, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes..... 2864

**VENDIM****Nr. 176, datë 9.3.2016****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 953, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 56, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) shtohen kodet e mëposhtme:

7305 11 00 - Hark gjatësor i fundosur i salduar;

7307 93 91 - Bërrylat dhe përkuljet;

b) hiqet kodi i mëposhtëm:

8414 20 20 – Pompa dore për mjetet të llojit biçikleta, motoçikleta, triçikle.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 177, datë 9.3.2016****PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, QË DËRGOHEN NË MISIIONE USHTARAKE JASHTË VENDIT, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me shoqërinë e sigurimeve “INSIG” sh.a., të bëjë sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2016.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2016.

3. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe shoqëria e sigurimeve “INSIG” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 178, datë 9.3.2016****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHUMËPALËSHE, TË AUTORITETIT KOMPETENT, PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARISË FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 146/2013, “Për ratifikimin e Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore”, dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent, për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



DEKLARATË

Unë, Shkëlqim Cani, ministër i Financave, në emër të Autoritetit Kompetent të Republikës së Shqipërisë, deklaroj pajtueshmërinë me dispozitat e

Marrëveshjes Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent mbi Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare

të referuar në vijim si “Marrëveshja” dhe bashkëlidhur kësaj Deklarate.

Me anë të kësaj Deklarate, Autoriteti Kompetent i Republikës së Shqipërisë konsiderohet nënshkrues i Marrëveshjes, prej datës 29 tetor 2014*, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në lidhje me Autoritetin Kompetent të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 7 të saj.

Njoftimi i aneksit F i kërkuar nga neni 3(3) i Marrëveshjes depozitohet nëpërmjet këtij dokumenti.

Nënshkruar në Berlin, më 29 tetor 2014.

/nënshkrimi dhe vula/
Shkëlqim Cani
Ministër i Financave

**MARRËVESHJA SHUMËPALËSHE
E AUTORITETIT KOMPETENT PËR
SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË
INFORMACIONIT TË LLOGARISË
FINANCIARE**

Ndërsa Juridiksionet e nënshkruesve të Marrëveshjes Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent mbi Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare (Marrëveshja) janë Palë ose territore që mbulohen nga Konventa për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore ose Konventën për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në çështjet tatimore e ndryshuar nga Protokollu që ndryshon Konventën për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore (Konventa), ose kanë nënshkruar apo shprehur synimin e tyre për të nënshkruar Konventën dhe pranojnë se Konventa duhet të jetë në fuqi dhe në efekt në lidhje me ta para se të ndodhë shkëmbimi i parë i informacionit të llogarisë financiare.

Ndërsa Juridiksionet synojnë të përmirësojnë pajtueshmërinë ndërkombëtare tatimore nëpërmjet ndërtimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të tyre në lidhje me ndihmën e ndërsjellë në çështjet tatimore;

Ndërsa Standardi i Përbashkët i Raportimit u zhvillua nga OECD-ja me vendet e G20 për të trajtuar shmangien nga tatimet dhe evazionin dhe për përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore;

Ndërsa një vend që ka nënshkruar ose shprehur synimin e tij për të nënshkruar këtë Konventë do të bëhet një Juridiksion vetëm siç përcaktohet në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, pasi ai të jetë bërë fillimisht Palë në Konventë;

Ndërsa ligjet e Juridiksioneve përkatëse kërkojnë ose pritet të kërkojnë nga institucionet financiare që këto të fundit të raportojnë informacion në lidhje me llogari të caktuara dhe të ndjekin procedurat që lidhen me verifikimin, në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe procedurat e raportimit dhe të verifikimit, të përcaktuara në Standardin e Përbashkët të Raportimit;

Ndërsa pritet që ligjet e Juridiksioneve të ndryshohen herë pas here për të reflektuar përditësime në Standardin e Përbashkët të Raportimit dhe pasi ndryshime të tilla miratohen nga një Juridiksion, përkufizimi i Standardit të Përbashkët të Raportimit do të konsiderohet se i referohet versionit të përditësuar në lidhje me atë Juridiksion;

Ndërsa kreu III i Konventës autorizon shkëmbimin e informacionit për qëllime tatimore, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi baza automatike, dhe i lejon autoritetet kompetente të Juridiksioneve të bien dakord mbi fushën e veprimit dhe modalitetet e shkëmbimeve të tilla automatike;

Ndërsa neni 6 i Konventës parashtrohet që dy ose më shumë Palë mund të bien dakord reciprokisht për të shkëmbyer informacion në mënyrë automatike, shkëmbimi i informacionit do të kryhet mbi baza dypalëshe ndërmjet autoriteteve kompetente;

Ndërsa Juridiksionet kanë ose pritet të kenë në kohën e shkëmbimit të parë: i) garancitë e duhura për të siguruar që informacioni i marrë në pajtim me këtë Marrëveshje mbetet konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në Konventë; dhe ii) infrastrukturën për një marrëdhënie efektive shkëmbimi (duke përfshirë



edhe proceset e përcaktuara për të siguruar shkëmbime informacioni në kohën e duhur, të sakta dhe konfidenciale, komunikime efektive dhe të besueshme, dhe aftësitë për të zgjidhur menjëherë çështjet dhe shqetësimet në lidhje me shkëmbimet apo kërkesat për shkëmbime dhe për administrimin e dispozitave të nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje);

Ndërsa Autoritetet Kompetente të Juridiksioneve synojnë të lidhin një marrëveshje për të përmirësuar pajtueshmërinë tatimore ndërkombëtare bazuar në shkëmbimin automatik në pajtim me këtë Konventë, pa cenuar procedurat legislative kombëtare (nëse ka), duke respektuar ligjin e BE-së (nëse zbatohet) dhe në bazë të dispozitës së konfidencialitetit dhe mbrojtjeve të tjera të parashikuara në këtë Konventë, përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informacionit të shkëmbyer në përputhje me to;

Për këtë arsye, Autoritetet Kompetente kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) termi “Juridiksion” nënkupton një vend ose territor për të cilin Konventa është në fuqi dhe efekt, qoftë nëpërmjet nënshkrimit dhe ratifikimit, në përputhje me nenin 28 ose nëpërmjet shtrirjes territoriale, në përputhje me nenin 29, dhe që është palë nënshkruese e kësaj Marrëveshjeje;

b) termi “Autoritet Kompetent” nënkupton, për çdo Juridiksion përkatës, personat dhe autoritetet e renditura në aneksin B të Konventës;

c) termi “Institucion Financiar Juridiksioni” nënkupton, për çdo Juridiksion përkatës: i) çdo institucion financiar që është rezident në Juridiksion, por përjashton çdo degë të atij institucioni financiar që ndodhet jashtë Juridiksionit; dhe: ii) çdo degë e një institucioni financiar që nuk është rezident në Juridiksion, nëse kjo degë është e vendosur në Juridiksionin në fjalë;

d) termi “Institucion Raportimi Financiar” nënkupton çdo Institucion Financiar Juridiksioni që nuk është Institucion Financiar Joraportues;

e) termi “Llogari e Raportueshme” nënkupton një Llogari Financiare e cila mbahet nga Institucioni i Raportimit Financiar dhe, e cila, sipas procedurave verifikuese në përputhje me

Standardin e Përbashkët të Raportimit, është identifikuar si një llogari e cila mbahet nga një ose më shumë persona që janë Persona Raportues në lidhje me një Juridiksion tjetër apo nga një njësi ekonomike jofinanciare pasive, me një ose më shumë Persona Kontrollues, të cilët janë Persona Raportues në lidhje me një Juridiksion tjetër;

f) termi “Standard i Përbashkët i Raportimit” nënkupton standardin për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare në çështjet tatimore (i cili përfshin Komentet), të zhvilluar nga OECD-ja me vendet e G20;

g) termi “Sekretariati i Organit Koordinues” nënkupton Sekretariatën e OECD-së që sipas paragrafit 3, të nenit 24, të Konventës, ofron mbështetje për organin koordinues të përbërë nga përfaqësuesit e Autoriteteve Kompetente të Palëve në Konventë;

h) termi “Marrëveshja në fuqi” nënkupton, në lidhje me çdonjërin prej dy Autoriteteve Kompetente, se të dyja Autoritetet Kompetente kanë treguar qëllimin e tyre për të shkëmbyer informacion automatikisht me njëri-tjetrin dhe kanë plotësuar kushtet e tjera të përcaktuara në nënparagrafin 2.1, të nenit 7. Autoritetet Kompetente për të cilat kjo Marrëveshje është në fuqi renditen në aneksin E.

2. Termat me germa kapitale, të papërkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin që i është dhënë në atë kohë sipas ligjit të Juridiksionit zbatues të Marrëveshjes, kuptim i cili është në përputhje me kuptimin e përcaktuar në Standardin e Përbashkët të Raportimit. Çdo term i papërkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje apo në Standardin e Përbashkët të Raportimit, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe ose Autoritetet Kompetente bien dakord për një kuptim të përbashkët (siç lejohet nga legjislacioni i brendshëm), kanë kuptimin që u është dhënë atyre në atë kohë sipas ligjit të Juridiksionit zbatues të Marrëveshjes, ndonjë kuptim sipas ligjeve tatimore në fuqi të atij Juridiksioni që kanë përparësi mbi kuptimin që i është dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij Juridiksioni.

Neni 2

Shkëmbimi i informacionit në lidhje me Llogaritë e Raportueshme

1.1 Në bazë të dispozitave të neneve 6 dhe 22, të Konventës, dhe raportimit të zbatueshëm dhe



rregullave të verifikimit në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit, secili Autoritet Kompetent do të shkëmbejë çdo vit me organet e tjera kompetente, në lidhje me të cilat zbaton këtë Marrëveshje, mbi baza automatike, informacione të marra në bazë të rregullave të tilla dhe të specifikuara në paragrafin 2.

1.2 Pavarësisht nga paragrafi i mëparshëm, Autoritetet Kompetente të Juridiksioneve të renditura në aneksin A dërgojnë, por nuk marrin informacionin e specifikuar në paragrafin 2. Autoritetet Kompetente të Juridiksioneve të parenditura në aneksin A gjithmonë do të marrin informacionin e specifikuar në paragrafin 2. Autoritetet Kompetente nuk e dërgojnë informacionin e tillë për Autoritetet Kompetente të Juridiksioneve të renditura në aneksin A.

2. Informacioni që do të shkëmbehet në lidhje me çdo Llogari të Raportueshme të një Juridiksioni tjetër përfshin:

a) Emrin, adresën, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes (në rastin e një individi) të secilit Person të Raportueshëm që është Mbajtës i Llogarisë dhe në rastin e një njësie ekonomike që është Mbajtës Llogarie dhe që pas zbatimit të procedurave të verifikimit në pajtim me Standardin e Përbashkët të Raportimit, identifikohet të ketë një ose më shumë Persona Kontrollues, Person i Raportueshëm, emrin, adresën dhe NIPT-in e Njësisë Ekonomike dhe emrin, adresën, NIPT-in, datën dhe vendin e lindjes të secilit Person të Raportueshëm;

b) Numrin e llogarisë (ose ekuivalentin funksional në mungesë të një numri të llogarisë);

c) Emrin dhe numrin identifikues (nëse ka) të Institucionit Financiar Raportues;

d) Gjendjen e llogarisë ose vlerën (duke përfshirë, në rastin e Kontratës së Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratë Pensioni Vjetor, Vlerën në Para të Gatshme ose vlerën e dorëzimit) në fund të vitit përkatës kalendarik ose një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi ose nëse llogaria është mbyllur gjatë atij viti apo asaj periudhe, mbyllet e llogarisë;

e) Në rastin e një Llogarie Kujdestarie:

1) shumën totale bruto të interesit, shuma totale bruto të dividendëve, dhe shumën totale bruto të të ardhurave të tjera të krijuara në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari, në çdo rast paguar apo kredituar në llogari (ose në lidhje me llogarinë) gjatë

vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe

2) të ardhurat totale bruto nga shitja apo shlyerja e aktiveve financiare të paguara apo të kredituara në llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme të raportimit në lidhje me të cilin Institucioni i Raportimit Financiar vepron, si: kujdestar, ndërmjetës, kandidat ose ndryshe si një agjent për Mbajtësin e Llogarisë;

f) Në rast të ndonjë Llogarie Depozite, shumën totale bruto të interesit të paguar apo të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi; dhe

g) Në rast të ndonjë llogarie të papërshekruar në paragrafin 2 (e) ose (f), shumën totale bruto të paguar apo të kredituar për Mbajtësin e Llogarisë në lidhje me llogarinë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi në lidhje me të cilën Institucioni i Raportimit Financiar është institucioni që ka detyrim ose debitori, duke përfshirë edhe shumën totale të pagesave të shlyerjeve të bëra për Mbajtësin e Llogarisë gjatë vitit kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi.

Neni 3

Koha dhe mënyra e shkëmbimit të informacionit

1. Për qëllime të shkëmbimit të informacionit në nenin 2, shuma dhe karakterizimi i pagesave të bëra në lidhje me një Llogari të Raportueshme mund të përcaktohen në përputhje me parimet e ligjeve tatimore të Juridiksionit që kryen shkëmbimin e informacionit.

2. Për qëllime të shkëmbimit të informacionit në nenin 2, informacioni i shkëmbyer do të identifikojë monedhën në të cilën është shprehur çdo shumë përkatëse.

3. Në lidhje me paragrafin 2, të nenit 2, dhe në bazë të procedurës së njoftimit të përcaktuar në nenin 7, duke përfshirë datat e specifikuara aty, informacioni do të shkëmbehet duke filluar nga vitet e specifikuara në aneksin F, brenda nëntë muajve pas përfundimit të vitit kalendarik me të cilin lidhet informacioni. Pavarësisht nga fjalia e mësipërme, informacioni kërkohet të shkëmbehet vetëm lidhur me një vit kalendarik nëse të dyja Autoritetet Kompetente kanë këtë Marrëveshje në fuqi dhe Juridiksionet e tyre përkatëse zbatojnë legjislacionin që kërkon raportim në lidhje me vitin



kalendariq që është në përputhje me qëllimin e shkëmbimit të parashikuar në nenin 2 dhe procedurat e raportimit dhe të verifikimit të përfshira në Standardin e Raportimit të Përbashkët.

4. [fshirë]

5. Autoritetet kompetente do të shkëmbejnë automatikisht informacionin e përshkruar në nenin 2 në skemën standarde të raportimit të përbashkët në një gjuhë të zgjedhur të caktuar.

6. Autoritetet Kompetente do të punojnë në drejtim të dhe do të bien dakord mbi një ose më shumë metoda për transmetimin e të dhënave, duke përfshirë standardet e kodimit, me synim maksimizimin e standardizimit dhe minimizimin e kompleksiteteve dhe shpenzimeve dhe do t'i specifikojnë në aneksin B.

Neni 4

Bashkëpunimi mbi pajtueshmërinë dhe zbatimin

Një Autoritet Kompetent do të njoftojë Autoritetin tjetër Kompetent kur Autoriteti i përmendur së pari ka arsye të besojë se një gabim mund të ketë çuar në informacione të pasakta ose të paplota, ose raportimi nuk është në pajtim, nga një Institucion Raportimi Financiar, me kërkesat e zbatueshme të raportimit dhe procedurat e verifikimit në përputhje me Standardin e Raportimit të Përbashkët. Autoriteti kompetent do të njoftohet të ndërmarrë të gjitha masat e duhura, të disponueshme sipas ligjit të tij të brendshëm për të trajtuar gabimet ose papajtueshmërinë e përshkruar në njoftim.

Neni 5

Konfidencialiteti dhe ruajtja e të dhënave

1. I gjithë informacioni i shkëmbyer pajtohet me rregullat e konfidencialitetit dhe masave të tjera mbrojtëse të parashikuara në këtë Konventë, duke përfshirë dispozitat që kufizojnë përdorimin e informacionit të shkëmbyer dhe, në masën e nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me masat mbrojtëse të cilat mund të specifikohen nga Autoriteti Kompetent dhënë, siç kërkohet sipas ligjit të tij të brendshëm dhe renditet në shtojcën C.

2. Një Autoritet Kompetent do të njoftojë menjëherë Sekretariatit e Organit Koordinues në lidhje me çdo shkelje të konfidencialitetit apo dështimin e masave mbrojtëse dhe për çdo

sanksion dhe veprime përmirësuese pasuese. Sekretariati i Organit Koordinues do të njoftojë të gjitha autoritetet kompetente në lidhje me të cilat zbatohet kjo marrëveshje me Autoritetin Kompetent të përmendur më parë.

Neni 6

Konsultimet dhe amendimet

1. Në rast të ndonjë vështirësie që lind në zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, Organi Kompetent mund të kërkojë konsultime me një ose më shumë Autoritete Kompetente për zhvillimin e masave të duhura për sigurimin e përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje. Autoriteti Kompetent që ka kërkuar konsultimet duhet të sigurojë, sipas nevojës, që Sekretariati i Organit Koordinues të njoftohet për masat që janë zhvilluar dhe Sekretariati i Organit Koordinues do të njoftojë të gjitha Autoritetet Kompetente, edhe ato që nuk marrin pjesë në konsultime, për masat e zhvilluara.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me konsensus me marrëveshje me shkrim të të gjitha Autoriteteve Kompetente që zbatojnë Marrëveshjen. Me përjashtim të rastit kur bihet dakord ndryshe, një amendament i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej një muaji pas datës së nënshkrimit të fundit të marrëveshjes së tillë me shkrim.

Neni 7

Afati i marrëveshjes

1. Autoriteti Kompetent duhet të garantojë, në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose sa më shpejt që të jetë e mundur pasi Juridiksioni i tij zbaton ligjet e nevojshme për zbatimin e Standardit të Përbashkët të Raportimit, një njoftim për Sekretariatit e Organit Koordinues kur specifikohen sa më poshtë:

a) që Juridiksioni i tij zbaton ligjet e nevojshme për zbatimin e Standardit të Përbashkët të Raportimit dhe datat përkatëse efektive në lidhje me llogaritë paraekzistuese, llogaritë e reja dhe aplikimin ose përfundimin e raportimit dhe procedurat e verifikimit;

b) ku konfirmohet nëse Juridiksioni duhet të listohet në aneksin A;

c) ku specifikohen një ose më shumë metoda për transmetimin e të dhënave, përfshirë kodimin (aneksi B);



d) ku specifikohen masat mbrojtëse, nëse ka, për mbrojtjen e të dhënave personale (aneksi C);

e) që zbaton masat e nevojshme për të garantuar plotësimin e standardeve të konfidencialitetit dhe të masave për mbrojtjen e të dhënave dhe se bashkëlidhur gjendet një pyetësor i plotësuar për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave, për t'u përfshirë në aneksin D; dhe

f) një listë të Juridiksioneve të Autoriteteve Kompetente në lidhje me të cilat synon të zbatojë dhe të ketë në fuqi këtë Marrëveshje, duke ndjekur procedurat legjislative kombëtare (nëse ka).

Autoritetet Kompetente duhet të njoftojnë menjëherë Sekretariatit e Organit Koordinues, për çdo ndryshim të mëvonshëm që do të bëhet në anekset e sipërpërmendura.

2.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ndërmjet dy Autoriteteve Kompetente në datën më të vonshme nga datat e mëposhtme: i) datën në të cilën i dyti nga dy Autoritetet Kompetente i jep njoftim Sekretariatit të Organit Koordinues sipas paragrafit 1, duke përfshirë listimin e Juridiksionit të Autoritetit Kompetent për pajtim me nënparagrafin 1 (f) dhe, nëse zbatohet; ii) datën në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi dhe është në fuqi për të dyja juridiksionet.

2.2 Sekretariati i Organit Koordinues do të mbajë një listë e cila do të publikohet në faqen e internetit të OECD-së të Autoriteteve Kompetente që kanë nënshkruar Marrëveshjen dhe ndërmjet të cilëve zbatohet kjo Marrëveshje (aneksi E).

2.3 Sekretariati i Organit Koordinues do të publikojë në faqen e internetit të OECD-së informacionin e ofruar nga Autoritetet Kompetente sipas nënparagrafëve 1(a) dhe (b). Informacioni i siguruar sipas nënparagrafëve 1(c) deri në (f) do të disponohet për nënshkruesit e tjerë pas kërkesës me shkrim për Sekretariatit e Organit Koordinues.

3. Autoriteti Kompetent mund të pezullojë shkëmbimin e informacionit sipas kësaj Marrëveshjeje, duke njoftuar me shkrim Autoritetin tjetër Kompetent që ka përcaktuar se nuk ka ose nuk ka pasur mospajtueshmëri të konsiderueshme nga Autoriteti i dytë i përmendur Kompetent me këtë Marrëveshje. Pezullimi i tillë do të ketë efekt të menjëhershëm. Për qëllime të këtij paragrafi,

mospajtueshmëria e konsiderueshme përfshin, por nuk kufizohet në mospajtueshmërinë me dispozitat e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave të kësaj Marrëveshjeje dhe të Konventës, pamundësinë nga Autoriteti Kompetent për të dhënë informacion në kohë ose informacion të mjaftueshëm siç kërkohet sipas kësaj Marrëveshjeje ose përcaktimin e statusit të subjekteve apo llogarive si Institucione Financiare Joraportuese dhe Llogarive të Përrjashtuara në një mënyrë që pengon qëllimet e Standardit të Raportimit të Përbashkët.

4. Autoriteti Kompetent mund të ndërpresë pjesëmarrjen e tij në këtë Marrëveshje ose në lidhje me një Autoritet Kompetent të veçantë, duke i dhënë njoftim me shkrim për ndërprerjen Sekretariatit të Organit Koordinues. Përfundimi i tillë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej 12 muajsh pas datës së njoftimit të ndërprerjes. Në rast të ndërprerjes, i gjithë informacioni i marrë më parë sipas kësaj Marrëveshjeje do të mbetet konfidencial dhe në bazë të kushteve të Konventës.

Neni 8

Sekretariati i Organit Koordinues

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, Sekretariati i Organit Koordinues do të njoftojë të gjitha Autoritetet Kompetente për njoftimet që ai merr në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe do të japë një njoftim për të gjithë nënshkruesit e Marrëveshjes kur një autoritet i ri kompetent nënshkruan Marrëveshjen.

2. Të gjithë nënshkruesit e Marrëveshjes do të ndajnë në mënyrë të barabartë, mbi baza vjetore, shpenzimet për administrimin e marrëveshjes nga ana e Sekretariatit të Organit Koordinues. Pavarësisht nga fjalia e mëparshme, vendet e kualifikuara do të përjashtohen nga ndarja e shpenzimeve në përputhje me nenin X të Rregullores së Procedurës së Organit Koordinues të Konventës.

Hartuar në gjuhën angleze dhe franceze, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike.



ANEKSI A
LISTA E JURIDIKSIONEVE JORECIPROKE
[për plotësim]



ANEKSI B
METODAT E TRANSMETIMIT
[për plotësim]



ANEKSI C
MASAT MBROJTËSE TË SPECIFIKUARA TË TË DHËNAVE
[për plotësim]



ANEKSI D
PYETËSOR MBI KONFIDENCIALITETIN
[për plotësim]



ANEKSI E
AUTORITETET KOMPETENTE PËR TË CILAT ZBATOHET KJO MARRËVESHJE
[për plotësim]



ANEKSI F
TË DHËNAT E SHKËMBIMIT TË SYNUAR

Llogari	Të synuara të përkufizohen si	Datat e synuara për shkëmbimin e informacionit		
Llogari të reja	Një Llogari Financiare që ruhet nga një Institucion Raportimi Financiar i hapur më ose pas datës 1 janar 2017	Shtator 2018		
		Llogari Individuale të Vlerës së Lartë	Llogari Individuale të Vlerës së Ulët	Llogari të Njësive Ekonomike
Llogari paraekzistuese	Një Llogari Financiare që ruhet nga një Institucion Raportimi Financiar më 31 dhjetor 2016	Shtator 2018	Shtator 2018 ose shtator 2019, në varësi se kur identifikohet si e raportueshme	Shtator 2018 ose shtator 2019, në varësi se kur identifikohet si e raportueshme

VENDIM
Nr. 179, datë 9.3.2016

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 505, datë 1.8.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”, shfuqizohet.

3. Vendimi nr. 624, datë 11.6.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Licencimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

STATUTI I QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Neni 1
Të përgjithshme

1. Termat e përdorur në këtë statut, përveçse kur ky akt parashikon ndryshe, do të kenë kuptimin që u është dhënë, përkatësisht, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të

Regjistrimit”, të ndryshuar (në vijim “Ligji për regjistrimin e biznesit”) dhe ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “Ligji për licencat, autorizimet dhe lejet”).

2. Në këtë statut, me termin:

a) “Ligj” do të kuptohet ligji nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;

b) “Ligjet funksionale” do të kuptohen, së bashku, ligji për regjistrimin e biznesit dhe ligji për licencat, autorizimet dhe lejet.

Neni 2
Statusi institucional

1. Qendra Kombëtare e Biznesit, në vijim QKB, organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit dhe të këtij statuti.

2. QKB-ja është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit, dhe e ka selinë në Tiranë.

3. QKB-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat e veta.

Neni 3
Misioni

QKB-ja ka për mision lehtësimin e procedurave të regjistrimit të biznesit dhe të licencimit, lejimit, autorizimit dhe mbështetjes së institucioneve publike në vendimmarrjen për krijimin e një mjedisi rregullator miqësor.

Neni 4
Funksionet

QKB-ja ka këto funksione:

a) Mban regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit;



b) Kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit për regjistrimin e biznesit;

c) Kryen regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin për regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës;

ç) Lëshon certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, sipas përcaktimit të ligjit për regjistrimin e biznesit;

d) Publikon të dhënat e regjistruara, sipas ligjit për regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to;

dh) Trajton procedurat e licencimit / autorizimit/lejeve, ndryshimit dhe revokimit të tyre, sipas ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet;

e) Mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet;

ë) Siguron aksesin e lirë të publikut në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet;

f) Informon dhe këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit, autorizimit e lejit;

g) Jep mendim për çdo nismë ligjore apo nënligjore në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licencave, autorizimeve e lejeve;

gj) Kryen studime për cilësinë e mjedisit rregullator, mbështet me informacion, analiza e këshilla ministrin, Këshillin e Ministrave apo institucionet qendrore e të pavarura, në lidhje me nismat e tyre normative dhe organizative në fushën e regjistrimit të biznesit e të licencave, autorizimeve e lejeve, si dhe asiston në përgatitjen e politikave për përmirësimin e mjedisit rregullator në këto fusha.

Neni 5

Sportelet

1. QKB-ja organizohet në zyrën qendrore dhe në sportelet e shërbimit në territor.

2. QKB-ja ofron shërbim ndaj publikut, nëpërmjet:

a) Sportelit të saj në qendër apo sporteleve të shërbimit në territor, në rastet e parashikuara nga ligji, sipas organikës dhe strukturës së miratuar;

b) Sportelit të saj elektronik;

c) Sporteleve të shërbimit në territor, pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore;

ç) Sporteleve të shërbimit, të hapura në bashkëpunim dhe pranë Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose dhomave të tregtisë, rregulluar sipas legjislacionit përkatës.

3. Ngritja e sporteleve të shërbimit pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, të identifikuara sipas pikës 3, të nenit 4, të ligjit, kryhet në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, lidhur ndërmjet QKB-së dhe njësive përkatëse. Marrëveshja e bashkëpunimit përcakton kushtet e ofrimit të shërbimit dhe treguesit kryesorë të performancës, kualifikimet dhe kriteret e posaçme profesionale të nëpunësve të sportelit, si dhe trajnimet e detyrueshme për nëpunësit.

4. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore, përcaktuar sipas pikës 3, më sipër, shërbimi i sportelit kryhet si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e ligjit, me dispozitat e legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes vendore dhe me dispozitat e këtij statuti.

5. Ngritja e sporteleve të shërbimit pranë Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose dhomave të tregtisë, rregulluar sipas legjislacionit përkatës, të identifikuara sipas pikës 4, të nenit 4, të ligjit, kryhet nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që QKB-ja lidh me institucionet përkatëse. Marrëveshja e bashkëpunimit përcakton kushtet e ofrimit të shërbimit dhe treguesit kryesorë të performancës, kualifikimet e kriteret e posaçme profesionale të nëpunësve të sportelit, si dhe trajnimet e detyrueshme për nëpunësit.

6. Numri dhe vendndodhja e sporteleve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore apo organizatave të tjera, të përcaktuara në pikat 3 e 5, të këtij neni, miratohen nga ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, në bazë të planifikimit të nevojës për hapjen e sporteleve të shërbimit në territor dhe ngarkesës së mjaftueshme të veprimeve në sportel.

7. Të gjitha sportelet e shërbimit në territor lidhen *online* me sistemin qendror të QKB-së.

8. QKB-ja mund të kryejë funksionet e saj, sipas këtij ligji, edhe nëpërmjet hapjes së një sporteli elektronik për kryerjen e procedurave përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit dhe të ligjit që rregullon licencat, lejet dhe autorizimet.



9. Në rast se njësia përkatëse e qeverisjes vendore apo organizata, me të cilën QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, sipas këtij neni, nuk ofron shërbimin e sportelit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji apo me parashikimet e marrëveshjes së lidhur me QKB-në, titullari i QKB-së ka të drejtë t'i propozojë ministrit mbylljen e sportelit përkatës.

Neni 6

Stema dhe vula zyrtare

1. QKB-ja identifikohet me stemën dhe vulën e saj zyrtare.

2. Stema e QKB-së përbëhet nga Stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Qendra Kombëtare e Biznesit”.

3. QKB-ja dhe çdo sportel shërbimi kanë vulën e tyre zyrtare.

4. Vula e QKB-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, me ndryshime dhe shënimin identifikues “Qendra Kombëtare e Biznesit”.

5. QKB-ja pajiset me 4 ekzemplarë të vulës zyrtare.

6. Vulat e sporteleve të shërbimit kanë formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, me ndryshime dhe shënimin identifikues:

“Qendra Kombëtare e Biznesit, sporteli i shërbimit të _____ (emri përkatës i njësisë vendore apo subjektit tjetër me të cilin QKB-ja ka marrëveshje bashkëpunimi)”.

7. Vula e QKB-së dhe vulat e sporteleve të shërbimit prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Kushtet e vërtetimit të veprimeve elektronike, nëpërmjet sportelit elektronik të QKB-së, miratohen nga ministri sipas kërkesave të ligjeve funksionale.

Neni 7

Titullari i QKB-së

1. Titullari i QKB-së është nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues.

2. Titullari i QKB-së caktohet nga ministri sipas

procedurave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil.

3. Statusi i titullarit, emërimi, lirimi nga detyra, masat, procedurat disiplinore dhe vlerësimi i punës së tij bëhen sipas kërkesave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil.

Neni 8

Funksionet e titullarit

1. Titullari është përgjegjës për administrimin teknik, organizativ, financiar dhe të burimeve njerëzore të QKB-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në veçanti, titullari i QKB-së:

a) Është autoriteti përgjegjës për drejtimin, organizimin dhe kryerjen e funksioneve të QKB-së sipas ligjit;

b) Përfaqëson QKB-në në marrëdhënie me të tretët;

c) Është përgjegjës për administrimin e pasurisë së QKB-së dhe buxhetit të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) Është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore të QKB-së, në përputhje me këtë statut;

d) Është përgjegjës për ndjekjen dhe arritjen e objektivave specifike vjetore dhe të treguesve të cilësisë së shërbimit, të miratuara nga ministri;

dh) Është përgjegjës për veprimet e lidhura me ngritjen dhe funksionimin e sporteleve të shërbimit;

e) Shqyrton dhe zgjidh ankimet ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të QKB-së, sipas ligjeve funksionale.

2. Titullari i QKB-së ushtron udhëheqjen metodologjike për zbatimin e procedurave që ndiqen, sipas ligjeve funksionale dhe nxjerr, për këtë qëllim, urdhra e udhëzime të detyrueshëm për nëpunësit e QKB-së dhe për të gjitha sportelet e shërbimit.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrat e titullarit

Për realizimin e përgjegjësiave të mësipërme, titullari i QKB-së ka këto të drejta dhe detyra:

a) Organizon, koordinon dhe kontrollon zbatimin e ligjit dhe të ligjeve funksionale në QKB dhe në sportelet e shërbimit;

b) I propozon ministrit miratimin e programit të brendshëm të veprimtarisë së institucionit;

c) Organizon përgatitjen dhe i propozon ministrit buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;



ç) Vlerëson ngarkesën e veprimeve në sportelet e shërbimit dhe planifikon nevojën e përhapjes së sporteleve të shërbimit në territor;

d) I propozon ministrit planin e përhapjes së sporteleve të shërbimit, sipas përcaktimeve të ligjit;

dh) I propozon ministrit formatin e formularëve, të certifikatave e dokumenteve të tjera procedurale për kryerjen e funksioneve të QKB-së;

e) Miraton dhe firmos kontratat e punës me punonjësit administrativë të QKB-së;

ë) Përcakton kriteret e posaçme profesionale të nëpunësve të sportelit, si dhe trajnimet e nevojshme për ta;

f) Përcakton kushtet e ofrimit të shërbimit të sportelit dhe treguesit kryesorë të performancës;

g) Bën vlerësimin e cilësisë së shërbimit për çdo sportel shërbimi, jo më pak se një herë, në fund të vitit, në përputhje me treguesit e cilësisë së shërbimit, të miratuar nga ministri;

gj) Miraton programet e trajnimit për nëpunësit e QKB-së e të sporteleve të shërbimit dhe siguron trajnimin fillestar dhe periodik të tyre;

h) Nxjerr urdhra e udhëzime të detyrueshëm për QKB-në dhe nëpunësit e sporteleve të shërbimit, në lidhje me kryerjen e funksioneve të QKB-së. Për nëpunësit e QKB-së zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil, të parashikuara për rekrutimin, përzgjedhjen, periudhën e provës, lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë, transferimin, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil;

i) Nxjerr urdhra individualë lidhur me rregullimin e marrëdhënieve të punës të punonjësve administrativë të QKB-së;

j) Nxjerr urdhra të brendshëm, të detyrueshëm për menaxhimin administrativ dhe financiar të institucionit, sipas legjislacionit në fuqi;

k) I raporton ministrit për veprimtarinë e QKB-së dhe të sporteleve të shërbimit;

l) Përgatit dhe sugjeron akte nënligjore në zbatim të ligjit dhe ndryshimet e përmirësimit në aktet nënligjore;

ll) Kryen çdo detyrë dhe ushtron çdo të drejtë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi;

m) Nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera publike shqiptare apo të huaja.

Neni 10

Burimet njerëzore

1. Nëpunësit e QKB-së, me përjashtim të punonjësve administrativë, kanë arsim të lartë.

2. Nëpunësit e QKB-së, përfshirë nëpunësit e sportelit qendror të shërbimit, në selinë e saj, dhe të sporteleve të shërbimit që mund të hapen nga QKB-ja, janë nëpunës civilë. Për këta nëpunës zbatohen procedurat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, për rekrutimin, përzgjedhjen, periudhën e provës, lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë, transferimin, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil.

3. Detyrat e përcaktuara në legjislacionin e nëpunësit civil për “Njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore”, kryhen nga njësia përkatëse e shërbimeve mbështetëse të QKB-së.

4. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të QKB-së i nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

5. Nëpunësit e QKB-së kryejnë veprimtari të detyrueshme trajnimi, menjëherë pas emërimit të tyre, në mënyrë periodike dhe sa herë që kërkohet nga titullari i QKB-së, në bazë të vlerësimit të punës.

Neni 11

Nëpunësit e sporteleve në njësitë e qeverisjes vendore

1. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit, në njësitë e qeverisjes vendore ku ato krijohen, janë nëpunës të njërive vendore përkatëse.

2. Niveli i pagave dhe shpërblimeve të nëpunësve në sportelet e shërbimit, pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak. Struktura dhe numri i nëpunësve vendorë përcaktohet nga Kryetari i Bashkisë.

3. Me qëllim njësimin e shërbimit që i ofrohet publikut në të gjitha sportelet e shërbimit në territor, nëpunësit e këtyre sporteleve duhet të plotësojnë të njëjtat kriteret e posaçme profesionale që zbatohen për nëpunësit e sportelit qendror të QKB-së.

4. QKB-ja siguron për nëpunësit e këtyre sporteleve të njëjtin trajnim që zbatohet për nëpunësit e sportelit të saj qendror.



5. Nëpunësit e këtyre sporteleve kryejnë veprimtari të detyrueshme trajnimi, menjëherë pas emërimit të tyre, në mënyrë periodike dhe sa herë që kërkohet nga titullari i QKB-së, në bazë të vlerësimit të cilësisë së shërbimit.

6. Titullari i QKB-së kërkon zëvendësimin e nëpunësit, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën sipas treguesve të cilësisë të QKB-së dhe institucionit përkatës është i detyruar ta zëvendësojë punonjësën brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësit civilë.

Neni 12

Nëpunësit e sporteleve pranë subjekteve të tjera

1. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit, të hapura pranë Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose dhomave të tregtisë, rregulluar sipas legjislacionit përkatës, janë punonjës të subjektit me të cilin QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

2. Niveli i pagave dhe i shpërblimit, si dhe struktura e numri i punonjësve në sportelet e shërbimit pranë këtyre subjekteve, përcaktohen nga organet kompetente të subjektit me të cilin QKB-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

3. Me qëllim njësimit të shërbimit që i ofrohet publikut në të gjitha sportelet e shërbimit në territor, nëpunësit e këtyre sporteleve duhet të plotësojnë të njëjtat kriteret të posaçme profesionale që zbatohen për nëpunësit e sportelit qendror të QKB-së.

4. QKB-ja siguron për nëpunësit e këtyre sporteleve të njëjtin trajnim që zbatohet për nëpunësit e sportelit të saj qendror.

5. Nëpunësit e këtyre sporteleve kryejnë veprimtari të detyrueshme trajnimi, menjëherë pas emërimit të tyre, në mënyrë periodike dhe sa herë që kërkohet nga titullari i QKB-së, në bazë të vlerësimit të cilësisë së shërbimit.

6. Titullari i QKB-së kërkon zëvendësimin e nëpunësit, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën sipas treguesve të cilësisë të QKB-së dhe institucionit përkatës është i detyruar ta zëvendësojë punonjësën menjëherë.

Neni 13

Buxheti dhe mjetet themelore

1. Buxheti i QKB-së është pjesë përbërëse e buxhetit të ministrisë dhe përgatitet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Projektbuxheti i QKB-së përgatitet nën drejtimin e titullarit të saj, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Fondet për shpenzime korrente, për çdo sportel shërbimi të ngritur në njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë fonde të kushtëzuara.

4. Fondet e kushtëzuara, sipas pikës 3, parashikohen dhe livrohen në trajtën e një shume vjetore, për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore ku operojnë sportelet e shërbimit. Ato mbulojnë shpenzimet për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore për punonjësit e nevojshëm për kryerjen e funksionit, si dhe shpenzime operative për energji e mjete të nevojshme të konsumueshme për ushtrimin normal të veprimtarisë etj.

5. Fondet për shpenzime kapitale, për sportelet e shërbimit në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në institucionet, shpenzohen nga vetë QKB-ja.

6. Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me objektin e saj, mund të parashikojë dhe kryejë shpenzime operative ose kapitale shtesë për përmirësimin e shërbimeve të sportelit.

7. QKB-ja mban llogaritë në thesar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat dhe gjokat, për kryerjen e funksioneve sipas ligjit, përfshirë edhe ato të krijuara në sportelet e shërbimit, derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit.

9. Të ardhurat nga tarifat për shërbimet e tjera, të krijuara nga QKB-ja ose nga sportelet e shërbimit në njësitë e vetëqeverisjes vendore, derdhen vetëm në masën 10 për qind në buxhetin e shtetit. Pjesa prej 90 për qind përdoret nga QKB-ja për përmirësimin e funksionimit e të shërbimit. Mënyra e përdorimit të këtyre të ardhurave bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe ministrit të Financave.

10. Pajisjet e QKB-së dhe pajisjet e sporteleve të shërbimit në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në subjektet e tjera, të blera nga fondet e saj, janë në pronësi shtetërore të QKB-së dhe në përdorim të njësive vendore e në përdorim të institucioneve përkatëse.

11. QKB-ja përgjigjet për mirëmbajtjen e pajisjeve në përdorim të sporteleve, sipas pikës 10, më sipër, me përjashtim të mirëmbajtjes së zakonshme, e cila kryhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore apo institucionit përkatës.

12. Titullari i QKB-së përcakton kriteret për përdorimin e pajisjeve të sporteleve të shërbimit, të



blera me fondet e QKB-së, konform kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Neni 14
Auditimi i brendshëm

Veprimtaria financiare e QKB-së auditohet nga struktura e ministrisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 15
Komunikimi elektronik me autoritetet e tjera

1. Për të garantuar lehtësimin e procedurave të regjistrimit të biznesit dhe të trajtimit të licencimit/lejeve/autorizimeve në kompetencë të saj, QKB-ja realizon lidhjen dhe shkëmbimin e të dhënave me institucione dhe/apo baza të dhënash elektronike të institucioneve publike.

2. Marrëdhëniet, të drejtat dhe detyrimet e palëve, sipas pikës 1 më sipër, rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta, sipas ligjit.

Neni 16
Orari i marrëdhënieve me publikun

Titullari miraton orarin e marrëdhënieve me publikun të QKB-së dhe të sporteleve të shërbimit.

Neni 17
Raportimi dhe mbikëqyrja

1. Në fillim të çdo viti, ministri përcakton objektivat specifike vjetore dhe të treguesve të cilësisë së shërbimit të QKB-së.

2. Marrëdhëniet institucionale me ministrin mbahen nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë.

3. Titullari i QKB-së i raporton me shkrim ministrit sa herë që i kërkohet, por jo më pak se në fund të çdo tremujori, dhe i paraqet atij raportin vjetor të veprimtarisë teknike e financiare brenda muajit janar të çdo viti, për vitin e kaluar.

VENDIM

Nr. 180, datë 9.3.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E SASISË
MINIMALE TË BIOKARBURANTEVE
DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE,
TË RINOVUESHME, QË DO TË
PËRDOREN GJATË VITIT 2016 NË
SEKTORIN E TRANSPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 9876, datë 14.8.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me licencë të tipit A, janë të detyruara që të tregtojnë biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse, të rinovueshme, që përdoren në sektorin e transportit.

2. Sasia minimale e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që përdoren në sektorin e transportit, për vitin 2016, është 10% e sasisë totale të nënprodukteve të naftës, të cilat tregtohen nga shoqëritë e tregtimit me shumicë.

3. Organi shtetëror për kontrollin e respektimit të detyrimit, të përcaktuar me këtë vendim, është Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

4. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është përgjegjës, për:

a) Respektimin e përdorimit të sasisë minimale të biokarburanteve dhe lëndëve djegëse, të rinovueshme;

b) Kontrollin dhe respektimin e treguesve cilësorë të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë, në formë të pastër ose të përzier;

c) Kontrollin dhe kryerjen e analizave, në laboratorin qendror të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, për sasitë e importuara, para zhdoganimit, për sasitë e biokarburanteve dhe lëndëve djegëse, të rinovueshme, të prodhuara në vend, si dhe për kontrollin përpara shpërndarjes në stacionet e shitjes së karburantit.

5. Për mosrespektimin e detyrimeve të këtij vendimi, zbatohet sanksioni i përcaktuar në



shkronjën “g”, të pikës 1, të nenit 25, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

6. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 182, datë 9.3.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 860, DATË 10.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË
MBLEDHJES DHE ADMINISTRIMIT TË
TË ARDHURAVE PËR NDËRTIMET PA
LEJE DHE VLERAVE TË ZBATUESHME
PËR LEGALIZIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32, pika 3, e 43, pika 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“4. Pagesa e tarifës së shërbimit të kryhet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit me shkrim të ALUIZNI-t.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Për ndërtimet pa leje, njoftimi për pagesën e tarifës së shërbimit (në rastet kur kjo tarifë aplikohet), i dërgohet subjektit në rrugë postare ose i jepet në dorëzim menjëherë pas kualifikimit të ndërtimit për legalizim (data e vendimit të kualifikimit).

Në rast mospagimi të tarifës, ALUIZNI, pas miratimit të lejes së legalizimit, e dërgon atë për regjistrim me hipotekë ligjore mbi ndërtimin, sipas

nenit 54, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.”

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Për llogaritjen e penaltetit të legalizimit të shtesave të subjektit ndërtues, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si çmim minimal fiskal të përdoret vlera e koston mesatare të ndërtimit të banesave për m², bazuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, të miratuar në zbatim të shkronjës “dh”, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004. “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar.”.

4. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Për ndërtimet në zona ku nuk ka vlera të miratuara të koston mesatare, përlllogaritja të kryhet në bazë të mesatares aritmetike të kostove të zonave kufitare.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 183, datë 9.3.2016

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,
NDËRMJET MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI
QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË
“PARTIZANI” SHA, SI QIRAMARRËS,
PËR PASURINË “AMBIENTE TË
PRONËS NR. 4, ME EMËRTIM “REPARTI
USHTARAK NR. 4030, RRUGA “MYSLYM
KETA”, TIRANË”, NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:


1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënë, dhe shoqërisë “PARTIZAN” sh.a., si qiramarrës, për pasurinë “Ambiente të pronës nr. 4, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 4030, rruga “Myslym Keta”, Tiranë”, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me sipërfaqe të përgjithshme 37 000 (tridhjetë e shtatë mijë) m², nga të cilat, sipas genplanit, përkatësisht 5164.72 (pesë mijë e njëqind e

gjashtëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e dy) m² sipërfaqe ndërtimore dhe 31 835.28 (tridhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë pikë njëzet e tetë) m² sipërfaqe funksionale, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

KONTRATË QIRAJE

Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata

Lidhur

Në Tiranë, sot në datën _____ të muajit _____ të vitit 2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit _____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përfaqësuar me autorizim të Ministrit, nr. _____, datë _____.2016 nga z. _____,

_____ në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, i datëlindjes _____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i pajisur me letër njoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet “QIRADHËNËSI”

DHE

Shoqëria “PARTIZANI” sh.a., me seli qendrore në Tiranë, dhe me adresë: Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga: Ibrahim Rugova, Hotel Vila Park Numër Pasurie 4/136, zona kadastrale 8270, Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKR-ja me NIPT: K48130547V, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë Z. Gazmend Demi, i biri i _____, i datëlindjes _____.19__, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet “QIRAMARRËSI”.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. _____, datë _____.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 Euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si Qiradhënës dhe shoqërisë “PARTIZANI” sh.a.,

Faqe | 2866

si Qiramarrës, për pasurinë “Ambiente të pronës nr. 4, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 4030”, rruga “Myslym Keta”, Tiranë” të Ministrisë së Mbrojtjes” dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, si dhe kërkesës së shoqërisë “PARTIZANI” sh.a., në datën 17.2.2016, së bashku me “Qiramarrësin”, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore: “Ambiente të pronës nr. 4, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 4030”, rruga “Myslym Keta”, Tiranë”, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me sipërfaqe të përgjithshme, sipas genplanit, 37 000 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 5 164.72 m² dhe sipërfaqe funksionale 31 835.28 m².

Neni 2

Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për ushtrimin e veprimtarive në fushën e sportit, nëpërmjet ndërtimit të kompleksit sportiv “Akademia e Sportit e Klubit Partizani”.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzetë) vjet dhe hyn në fuqi me firmosjen e saj nga palët.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 “Qiradhënësi”, nëpërmjet Komandës Mbështetëse (strukturë në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura), si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira, i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 “Qiradhënësi” ka të drejtë të kontrollojë, në çdo kohë, për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e “Qiramarrësit”.



4.3 “Qiradhënësi” është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.4 “Qiradhënësi” ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 60 ditë përpara me shkrim.

4.5 “Qiradhënësi” nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 “Qiramarrësi” ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 “Qiramarrësi” ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2.

5.3 “Qiramarrësi” detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planbiznesin e paraqitur në konkurrim.

5.4 “Qiramarrësi”, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë, si punime ndërtimore për rikonstruksion, ndërtime të godinave dhe ambienteve të tjera, blerje dhe vendosje pajisjesh, një vlerë totale prej 200 004 000 (dyqind milionë e katër mijë) lekë, sipas parashikimit për investimet dhe fazat e zhvillimit të tij, të shprehura në planbiznesin e paraqitur, që janë si vijon:

Faza e parë: Me një investim prej 86 016 000 (tetëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh, brenda 12 muajve nga data e marrjes në dorëzim do të realizohet:

- mobilizimi i kantierit dhe punime dheu për sistemimin e sipërfaqes së tokës;
- kanalizime të domosdoshme për realizimin e infrastrukturës të furnizimit me energji elektrike, të furnizimit me ujë dhe të kullimit të ujërave;
- rrugë kryesore ndihmëse e të brendshme;
- punime për realizimin e bazamentit dhe katit -1 të godinës së akademisë;
- krahë i punës për fazën e parë kap vlerën e investimit.

Faza e dytë: Me një investim prej 50 400 000 (pesëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekësh, brenda 12 muajve nga data e mbylljes së fazës së parë do të kryhen këto punime:

- ndërtimi i fushave të stërvitjes, paneleve ndarës;
- logjistika, ndriçimi;
- ndërtimi i strukturës beton/arme të godinës së akademisë.

Faza e tretë: Me një investim prej 49 000 000 (dyzet e nëntë milionë) lekësh, brenda 12 muajve nga data e mbylljes së fazës së dytë, pra deri në dorëzim të impiantit do të kryhen këto punime:

- përfundimi i godinës së akademisë së bashku me infrastrukturën e nevojshme, si instalimet e sistemeve të ngrohje ftohjes, ventilim aspirimit dhe impiantistika e pishinës së brendshme;
- realizimi i mobilimit të akademisë;
- realizimi i hapësirave të gjelbra dhe pika e shërbimit bar-bufe.

5.5 “Qiramarrësi”, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në planbiznesin e paraqitur në konkurrim, detyrohet që, në objektin e marrë me qira, në përfundim të 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit, do të ketë të punësuar 50 (pesëdhjetë) punonjës.

5.6 “Qiramarrësi” detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit ndryshimet e planbiznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës.

5.7 “Qiramarrësi” detyrohet të paraqesë te “Qiradhënësi” në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.8 “Qiramarrësi” detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.9 “Qiramarrësi”, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. “Qiradhënësi” nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga “Qiramarrësi”.



5.10 Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

Neni 6

Pagesa e qirasë

6.1 “Qiramarrësi” detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës “Qiramarrësi” ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 4 000 080 (katër milionë e tetëdhjetë) lekë, sipas faturës së lëshuar nga “Qiradhënësi”, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.4 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoba dhe kamatvonesa), “Qiramarrësi” do të likuadojë vlerat e krijuara në llogarinë e “Qiradhënësit” sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

Penalitetet

7.1 Në rastin kur “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar investimet e përcaktuara në pikën 5.5, të kësaj kontrate, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të paralelizuar. Nëse pas 6 muajve investimi vazhdon të mos realizohet, “Qiradhënësi” zgjidh kontratën dhe gjobit “Qiramarrësin” me vlerën e garancisë së ngurtësuar në atë moment.

7.2 Në rastin kur, “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.5 të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune të pahapur.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- a) në marrëveshje midis palëve;
- b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;

c) kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate;

d) kur “Qiramarrësi” nuk pajiset me autorizim për përpunimin aktiv të mallrave ose rifreskimit të tij, për një periudhë mbi 5 (pesë) muaj.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 60 ditë pas njoftimit me shkrim të “Qiradhënësit” për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse “Qiramarrësi” nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9

Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të çdo faze për investimin, pas relacionit të paraqitur nga “Qiramarrësi”, sipas pikave 5.4, 5.5 dhe 5.6 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe “Qiramarrësit”, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël.

9.3 Palët, “Qiramarrësi” dhe Komanda Mbështetëse (strukturë në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura) janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me “forcë madhore” do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 “Qiramarrësi” përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimin të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.



Neni 10

Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do tu referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe procesverbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve, gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter Sokol Sh. Malaj, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Përfaqësuar nga:

Alban Beqaj

QIRAMARRËSI

Shoqëria “PARTIZANI” sh.a.

Përfaqësuar nga:

Gazmend Demi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë